Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

DREJTORIA E INSPEKTORATEVE
Inspektorati Komunal
Nr. 17-355- Zyrtarisht
Dt. 16.11.2026
P R I Z R E N

Inspektorati komunal duke vepruar sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 168 të Rregullorës për Shërbime Publike Komunale në Komunën e Prizrenit, me nr. 001/011-73507 të datës 04.06.2026 nxjerr këtë:

Nj O F T I M

Njoftohen të gjithë pronarët e lokaleve, shitësit ambulantë të cilët ekspozojnë mallra (pemë e perime, plastikë, etj) para lokaleve afariste, në rrugë dhe trotuare e që nuk janë të pajisur me leje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, si dhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kanë vendosur pengesa të ndryshme (shufra metalike, vazo betoni, goma, kona plastike etj.) në hapësira publike, e që nuk posedojnë leje përkatëse: inspektorati komunal do të ndërmerr aksion në datat 23 dhe 24.11.2026 si dhe ditëve në vazhdim për largimin e tyre me qëllim të lirimit të të gjitha hapësirave publike dhe krijimit të qasjes së lirë të qytetarëve në këto hapësira.

Paraprakisht, të gjithë pronarët që ekspozojnë mallra në hapësira publike, shitësit ambulantë si dhe personat fizikë dhe juridikë të cilët kanë vendosur pengesa të ndryshme janë njoftuar me shkrim dhe me gojë.

Të gjithë personat e lartpërmendur, që nuk veprojnë sipas këtij njoftimi do të gjobiten me gjoba administrative, si dhe mallrat dhe objektet tjera të përkohshme që nuk janë larguar sipas këtij njoftimi do të konfiskohen, ndërsa të gjitha shpenzimet rreth konfiskimit do t'i bartin pronarët e mallrave dhe objekteve të përkohshme.

Drejtoresha e Inspektorateve

Samra Ilijazi-Ljatic